



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 678 Akti

Nr. 748 Vendimi

Tiranë, më 27.3.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 25.3.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Milan Laskaj**, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në pikën 5 të nenit 3, si dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Milan Laskaj, aktualisht me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, është subjekt rivlerësimi që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Milan Laskaj, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Pamela Qirko dhe Xhensila Pine. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 22.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Alma Faskaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Milan Laskaj.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Milan Laskaj, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, ish-DSIK (AKSIK); Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Milan Laskaj. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin² e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, z. Milan Laskaj, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, duke dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, z. Milan Laskaj.

13. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; vlerësimin e aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 7.3.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Milan Laskaj; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

¹ Akti i përfundimit të kontrollit nr. *** prot., datë 30.3.2018.

² Raporti i AKSIK-së nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë 4.7.2023.

³ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 23.5.2023.

15. Subjekti i rivlerësimit në datën 7.3.2024 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 11.3.2024, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 21.3.2024 (nëpërmjet postës elektronike me *email*, si dhe duke i depozituar në Komision, protokolluar me nr. ***).

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 21.3.2024.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Milan Laskaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 25.3.2024, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

18. Subjekti i rivlerësimit, z. Milan Laskaj, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Milan Laskaj, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Z. Milan Laskaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

19.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë.

20.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë të përcaktuara qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.3 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.4 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

20.5 Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁴ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale, të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Pas administrimit të raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së tij. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së burimeve financiare, që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive.

22.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Milan Laskaj.

22.2 Në deklaratën *Vetting* (shtojca ***), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

⁴ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtar”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

23. Pasuria e llojit apartament banimi me sipërfaqe 91.4 m², prenotuar nga shoqëria “**** ” sh.p.k. me kontratën e porosisë së datës 19.2.2011, ndodhur në rrugën “****”, lagjja “Q”, Njësia Administrative D, me vlerë 38,000 euro, paguar shuma 36,000 euro⁵.

23.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat e tij si prokuror, duke sqaruar gjithashtu se në datën 29.7.2011 ka marrë kredi në Credins Bank në shumën 800,000 lekë, me afat 4 vjet, si dhe 200,000 lekë *overdraft*. Referon se kredinë dhe *overdraft*-in i ka shlyer tërësisht me të ardhurat nga paga e tij.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

24. Pas verifikimit të deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë (në vijim DIPP) të depozituara ndër vite në ILDKPKI, mbi deklaratimet e bëra nga subjekti të lidhura me pasurinë objekt vlerësimi, Komisioni konstaton se:

24.1 Në DIPP-në e vitit 2010, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar se ka lidhur një kontratë kapari për blerjen e një apartamenti banimi me sipërfaqe 79.4 m², me vlerë 32,000 euro, ndodhur në lagjen “Q”, Komuna D. Referon se në lidhje me këtë kontratë ka paguar shumën 10,000 euro dhe se i ka mbetur si detyrim shuma 22,000 euro. Si burim për pagesën e kryer në shumën 10,000 euro ka referuar të ardhurat e tij vjetore nga pagat dhe dietat e marra gjatë punës si prokuror.

24.2 Në DIPP-në e vitit 2011, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar se në datën 19.2.2011 ka lidhur kontratë porosie me shoqërinë “**** ” sh.p.k., për blerjen e një apartamenti banimi me sipërfaqe 91.4 m², me vlerë 38,000 euro, ndodhur në lagjen “Q”, Komuna D. Në vijim të deklaratimit ka sqaruar se ka paguar shumën 30,000 euro dhe i ka mbetur si detyrim shuma 8,000 euro. Si burim për kryerjen e kësaj pagese ka referuar të ardhurat vjetore nga pagat dhe dietat e marra gjatë punës si prokuror, kredia në shumën 800,000 lekë, si dhe *overdraft*-i në shumën 200,000 lekë. Gjithashtu ka deklaruar se ka marrë hua pa interes: (i) në datën 12.1.2011, shumën 5,000 euro nga shtetasi I.M ; (ii) në datën 20.1.2011, shumën 5,000 euro nga shtetasi N. L .

24.2.1 Në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të kësaj deklaratë, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: (i) shumën 5,000 euro marrë hua shtetasit I.M në datën 12.1.2011, pa afat shlyerjeje; (ii) shumën 5,000 euro marrë hua shtetasit N.L në datën 20.1.2011, pa afat shlyerjeje. Sqaron se këto shuma i ka marrë pa bërë kontratë apo deklaratë noteriale. Ka deklaruar se nuk ka shlyer asnjë pjesë nga këto shuma për vitin 2011. Detyrimi i mbetur: 10,000 euro.

24.2.2 Gjithashtu ka deklaruar kredinë e marrë në Credins Bank me kontratën e datës 29.7.2011, në shumën 800,000 lekë, duke evidentuar se gjatë vitit 2011 ka shlyer shumën 113,156 lekë dhe i ka mbetur pa shlyer detyrimi prej 725,882 lekësh.

⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentet: (i) kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.2.2011; (ii) leje ndërtimi nr. ***, datë 30.12.2009, lëshuar nga Komuna D për godinë banimi dhe shërbimi 5 kat + papafingo + 1 kat parkim për shoqërinë “****” sh.p.k. + praktika e shoqërisë “****” sh.p.k.; dhe (iii) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.1.2017.

24.3 Në DIPP-në e vitit 2012, krahas detyrimit vjetor të shlyer për kredinë e marrë në Credins Bank, subjekti ka deklaruar se i ka shlyer shumën prej 2,000 euro shtetasit I.M nga shuma prej 5,000 euro e marrë hua në vitin 2011.

24.4 Në DIPP-në e vitit 2013, krahas detyrimit vjetor të shlyer për kredinë e marrë në Credins Bank, subjekti ka deklaruar se i ka shlyer edhe shumën prej 2,000 euro shtetasit I.M , duke evidentuar se detyrimi i mbetur ndaj këtij shtetasi është në shumën 1,000 euro.

24.5 Në DIPP-në e vitit 2014, krahas detyrimit vjetor të shlyer për kredinë e marrë në Credins Bank, subjekti ka deklaruar se nga detyrimet e mëparshme të mbetura – 1,000 euro shtetasit I.M dhe 5,000 euro shtetasit N. L – ka shlyer në total gjatë vitit 2014 shumën 4,000 euro, duke evidentuar detyrimin e mbetur prej 2,000 euro.

24.6 Në DIPP-në e vitit 2015, krahas detyrimit vjetor të shlyer për kredinë e marrë në Credins Bank, subjekti ka deklaruar se gjatë vitit 2015 ka shlyer detyrimin e mbetur ndaj shtetasit N.L, në shumën 2,000 euro.

24.7 Në DIPP-në e vitit 2016, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar se i ka paguar shoqërisë “**** ” sh.p.k. shumën 6,000 euro, me burim të ardhurat nga paga dhe kursimet e vitit 2015, në shumën 300,000 lekë.

Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

25. Lidhur me pagesën e shumës prej 10,000 euro, sipas kontratës së kaparit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.5.2010, për porositjen e apartamentit me sipërfaqe 78.9 m², në Q , Komuna D , Tiranë, deklaruar me burim të ardhurat vjetore, rezulton se të ardhurat e realizuara deri në maj të vitit 2010 nuk justifikojnë shumën prej 10,000 euro. Gjithashtu rezulton se deri në DIPP-në e vitit 2009, subjekti nuk ka deklaruar likuiditete *cash*.

26. Mosdeklarim në DIPP-në e vitit 2011 të revokimit të kontratës së kaparit nr. *** rep., nr.*** kol., datë 26.5.2010.

27. Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer për pagesën e shumës 20,000 euro për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 91.4 m², në Q , Komuna D , Tiranë, pasi rezulton se kredia në Credins Bank është disbursuar në datën 29.7.2011, ndërsa kontrata e porosisë i përket datës 19.2.2011, ku është përcaktuar se vlera 30,000 euro është likuiduar me nënshkrimin e kontratës. Gjithashtu ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me mundësitë financiare të shtetasve I.M dhe N. L për dhënien e huave në shumën totale 10,000 euro, e cila është deklaruar ndër të tjera si burim për pagesën e kryer në vitin 2011.

28. Mospërputhje mes DIPP-së së vitit 2011 dhe deklaratës së pasurisë *Vetting* lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 91.4 m², ndodhur në Q , Tiranë, pasi në deklaratën e pasurisë *Vetting* është deklaruar “Të ardhura nga paga, kredi dhe overdraft”, ndërsa në DIPP-në e vitit 2011 është deklaruar krahas tyre edhe hua tek shtetasit I.M dhe N. L .

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

29. Nga verifikimi i dokumentacionit, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*,

si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri⁶, Komisioni konstaton se:

29.1 Në datën 26.5.2010, mes subjektit të rivlerësimit në cilësinë e kapardhënesit dhe shtetasit S.D në cilësinë e kaparmarrësit nënshkruhet kontrata e kaparit⁷, në të cilën përcaktohet se kaparmarrësi kërkon t'i shesë subjektit pasurinë e llojit apartament banimi me sipërfaqe 78.9 m², në objektin e ndërtuar/që po ndërtohej nga shoqëria “**** ” sh.p.k., pajisur me leje ndërtimi shoqëria “**** ” sh.p.k., të ndodhur në Q , Komuna D , për të cilin si kapar i është dhënë shuma 10,000 euro nga subjekti i rivlerësimit, shumë e cila deklarohet e dhënë dhe e marrë respektivisht nga palët, ndërsa për diferencën e mbetur përcaktojnë se do të paguhet kur kaparmarrësi të ndërtojë apartamentin e banimit dhe të nxjerrë dokumentet nga ZVRPP-ja Tiranë dhe, pas këtij momenti, do të bëhet akti përfundimtar i shitjes në favor të kapardhënesit. Rezulton se në kontratën e kaparit nuk është përcaktuar çmimi total i kësaj pasurie. Ndërkohë, në DIPP-në e vitit 2010, duke iu referuar kësaj kontrate, subjekti e deklaroi me vlerë 32,000 euro.

29.2 Në datën 19.2.2011, subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi S.D revokojnë⁸ kontratën e kaparit të datës 26.5.2010, duke u kthyer në gjendjen e mëparshme.

29.3 Po në datën 19.2.2011, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e porositësit dhe shoqëria “**** ” sh.p.k., me përfaqësues ligjor shtetasin S.D në cilësinë e sipërmarrësit, nënshkruajnë kontratën e porosisë⁹, me objekt porositjen e një apartamenti banimi me sipërfaqe 91.4 m², për çmimin 38,000 euro, në objektin 5-katësh + papafingo + 1 kat parkim, ku referohet se shoqëria në fjalë është sipërmarrëse dhe investitore sipas vendimit të KRRT-së së Komunës D , me nr. ***, datë 30.12.2009, leje e cila është dhënë në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shoqërisë “**** ” sh.p.k., ku të drejtën e ndërtimit dhe investimit të këtij objekti e ka shoqëria “**** ” sh.p.k.

29.3.1 Në këtë kontratë, plani i pagesave/mënyra e pagesës është përcaktuar si vijon: (i) kësti i parë prej 30,000 euro është paguar në momentin e nënshkrimit të saj; (ii) vlera 7,000 euro do të paguhet në momentin e dorëzimit të apartamentit; (iii) vlera 1,000 euro do të paguhet në momentin e dorëzimit të hipotekës.

29.4 Në datën 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi S.D nënshkruajnë një deklaratë noteriale¹⁰ midis tyre, në referim të së cilës subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka porositur për të blerë një apartament me shoqërinë “**** ” sh.p.k., Tiranë, me përfaqësues ligjor z. S.D, referuar kontratës së porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.2.2011, në bazë të së cilës i ka likuiduar z. S.D shumën 6,000 euro me dy këste: një herë shumën 3,000 euro në datën 30.5.2016 dhe përsëri shumën 3,000 euro në datën 20.11.2016. Këto rrethana deklarohen edhe nga shtetasi S.D, duke u pranuar marrja në dorëzim e këtyre vlerave monetare.

⁶ (i) Dokumentacioni i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* (ndodhur në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së); (ii) dokumentacioni i përcjellë me shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 11.10.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 13.10.2023); (iii) dokumentacioni i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ prej zyrave noteriale; (iv) dokumentacioni i depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ.

⁷ Kontratë kapari nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.5.2010, redaktuar nga noteri publik, znj. M.V.

⁸ Dokumenti noterial “Revokim i kontratës së kaparit” nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.2.2011, redaktuar nga noteri publik, znj. G.B .

⁹ Kontratë porosie nr. **** rep., nr. *** kol., datë 19.2.2011, redaktuar nga noteri publik, znj. G.B .

¹⁰ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.1.2017, redaktuar nga noteri publik, znj. A.L.

30. Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara ndër vite në ILDKPKI, Komisioni konstatoi se në DIPP-në e vitit 2010, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se ka lidhur një kontratë kapari (por pa deklaruar palën përfituese të kaparit) për blerjen e një apartamenti banimi me sipërfaqe 79.4 m², në lagjen “Q”, Komuna D, me vlerë 32,000 euro, duke referuar se ka paguar për këtë kontratë shumën 10,000 euro, mbetur për të paguar edhe shuma 22,000 euro. Sa i përket shumës së paguar, ka deklaruar se është siguruar nga të ardhurat vjetore nga paga dhe dietat e marra gjatë punës si prokuror.

31. I pyetur nga ILDKPKI-ja në datën 19.1.2016¹¹, në lidhje me këtë pasuri – apartamentin e deklaruar prej tij në DIPP-në e vitit 2010, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se burimi i shumës 10,000 euro, të dhënë si kapar në vitin 2010, ka qenë nga të ardhurat nga pagat dhe dietat për vitin 2010.

32. Nga ana tjetër, nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. *** të dërguar nga Komisioni evidentohet dokumenti deklaratë noteriale, datë 2.2.2021, nënshkruar prej tij dhe shoqërisë “****” sh.p.k. ku, ndër të tjera, referohet se shuma e kaparit për apartamentin me sipërfaqe 78.9 m² (deklaruar në DIPP-në e vitit 2010), në vlerën 10,000 euro, ishte paguar pjesërisht në vitin 2009, e ndarë në tri këste, në shumën totale prej 500,000 lekësh (subjekti ka depozituar tri mandatpagesa), ndërsa pjesa tjetër e shumës së mbetur prej rreth 6,400 euro (10,000 euro – 500,000 lekë) është paguar në vitin 2010.

32.1 Gjithashtu, në vijim të verifikimit të deklaratimeve të bëra nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. *** të dërguar nga Komisioni, rezulton se subjekti ka deklaruar se në maj të vitit 2010 ka marrë hua nga shtetasi P.H shumën 3,000 euro, referuar si e likuiduar brenda muajit korrik të vitit 2010. Në mbështetje të këtij deklarami, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale datë 2.2.2021 të këtij shtetasi, sipas së cilës, krahas deklaramit të dhënies dhe marrjes së kësaj shume, referohet se qëllimi i dhënies ka qenë për blerje apartament banimi¹².

33. Rezultoi se në DIPP-në e vitit 2011, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se në datën 19.2.2011 ka lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k. kontratë porosie për blerjen e një apartamenti banimi me sipërfaqe 91.4 m², në lagjen “Q”, Komuna D. Gjithashtu ka deklaruar se apartamenti është me vlerë 38,000 euro, nga të cilat janë paguar 30,000 euro, ndërsa pjesa tjetër prej 8,000 euro ka mbetur pa paguar. Si burim krijimi të shumës 30,000 euro ka deklaruar: (i) të ardhurat e tij vjetore nga paga dhe dietat; (ii) shumën 800,000 lekë nga kredia e marrë; (iii) shumën 200,000 lekë nga *overdraft*-i; (iv) hua në shumën 5,000 euro, të marrë nga shtetasi I.M në datën 12.1.2011; (v) hua në shumën 5,000 euro, të marrë nga shtetasi N. L në datën 20.1.2011.

34. Në kontratën e porosisë së datës 19.2.2011 është referuar se kësti i parë prej 30,000 euro është paguar në momentin e nënshkrimit të saj. Ndërkohë, referuar dokumentacion bankar të administruar në dosje, rezulton se kredia prej 800,000 lekësh është disbursuar në datën 29.7.2011, në Credins Bank. Po ashtu, Komisioni konstaton se *overdraft*-i nuk është tërhequr deri në datën 19.2.2011.

¹¹ Referojuni dokumentit “Procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive”, datë 19.1.2016, përcjellë me shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 11.10.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 13.10.2023).

¹² Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.2.2021, redaktuar nga noteri publik, znj. G.D.

35. I pyetur më parë nga ILDKPKI-ja në datën 16.1.2016, në lidhje me kontratën e sipërmarrjes datë 19.2.2011 për apartamentin me sipërfaqe 91.4 m², ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se në datën 19.2.2011 ka revokuar kontratën e kaparit për apartamentin me sipërfaqe 78.9 m² (deklaruar në DIPP-në e vitit 2010), duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme, dhe shuma prej 10,000 euro e paguar si kapar në vitin 2010 është konsideruar e llogaritur në vlerën 30,000 euro, të paguar ndaj palës së porositur më 19.2.2011, në funksion të likuidimit të çmimit për apartamentin e ri.

36. Gjithashtu, në vijim të verifikimit të shpjegimeve të dhëna nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. *** të dërguar nga Komisioni, evidentohet se subjekti ka deklaruar se në janar të vitit 2011 ka marrë hua nga shtetasja Z.B shumën 10,000 euro, referuar si e likuiduar brenda vitit 2011. Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të kësaj shtetaseje, datë 2.2.2021, sipas së cilës, krahas deklarimit të dhënies dhe marrjes së kësaj shume, referohet se qëllimi i dhënies ka qenë për blerje apartament banimi.

37. Pasi Komisioni i kërkoi të deklarojë mbi mospërputhjet e evidentuara në deklarimin/referimin/evidentimin e të ardhurave të referuara si burim krijimi i apartamentit të porositur në vitin 2010 e, në vijim, të apartamentit të porositur në vitin 2011 nga shoqëria “****” sh.p.k., si dhe mbi marrëdhëniet e huave të deklaruara gjatë hetimit administrativ¹³, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se:

38. Së pari, në lidhje me kontratën e kaparit të vitit 2010, referon se shuma prej 10,000 euro është paguar e ndarë në këste në vitet 2009 dhe 2010, përkatësisht 500,000 lekë në vitin 2009 dhe pjesa tjetër në vitin 2010, duke pretenduar gjithashtu se si burim për kryerjen e kësaj pagese ka shërbyer edhe një hua e marrë në maj të vitit 2010, në shumën 3,000 euro, nga shtetasi P.H.

38.1 Komisioni vëren se, edhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, si dhe me deklaratimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, duke pretenduar se pagesa e kryer në funksion të kontratës së kaparit të datës 26.5.2010 është ndarë në dy vite, përkatësisht 2009 dhe 2010.

38.2 Sa i përket këtij pretendimi – megjithëse i mbështetur në deklaratën noteriale të datës 2.2.2021, të nënshkruar mes subjektit dhe shoqërisë “**** ” sh.p.k. – rezulton se në DIPP-në e vitit 2009 subjekti nuk ka deklaruar pagesë të kryer në favor të kësaj shoqërie apo përfaqësuesve të saj ligjorë. Për më tepër, Komisioni evidenton faktin se në vazhdimësi – para nisjes së hetimit administrativ – subjekti ka deklaruar se kjo pagesë është kryer me të ardhurat e tij vjetore të vitit 2010. Gjithashtu rezulton se vetë kontrata e kaparit nuk referon pagesë të kryer me këste.

38.2.1 Lidhur me vlerën provuese të deklaratës noteriale të nënshkruar mes subjektit dhe shoqërisë “**** ” sh.p.k., sjellim në vëmendje qëndrimet¹⁴ që ka mbajtur Kolegji në çështje të ndryshme, sipas të cilave, megjithëse nuk është e pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e saj provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se u vlerësua në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve të

¹³ Pyetja nr. *** e pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

¹⁴ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2018 (JR), datë 12.9.2018, paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, paragrafi 27.12.1; nr. 34/2019 (JR), datë 2.12.2019, paragrafi 85.2; nr. 23/2020 (JR), datë 25.9.2020, paragrafi 26.2; nr. 11/2021(JR), datë 31.3.2021, paragrafi 26.2.

dhëna në to me provat e tjera dhe çdo të dhëna apo informacioni të administruar në fashikull gjatë hetimit administrativ.

38.3 Për rrjedhojë, në analizën financiare përfundimtare Komisioni do të reflektojë se kjo vlerë është shlyer tërësisht në vitin 2010, më konkretisht në datën 26.5.2010, me nënshkrimin e kontratës së kaparit.

38.4 Referuar deklaramëve të bëra nga subjekti në ILDKPKI, rezulton se nuk janë deklaruar shtesa likuiditetesh *cash* deri në fund të vitit 2009. Në këto kushte, duket se si burim për kryerjen e kësaj pagese mund të kenë shërbyer vetëm të ardhurat e subjektit për periudhën janar – maj të vitit 2010.

38.5 Gjithashtu rezulton se gjatë hetimit administrativ subjekti ka konfirmuar se shuma 3,000 euro, e deklaruar nga shtetasi P.H si e dhënë hua në maj të vitit 2010, ka pasur si qëllim pagesën e kaparit. Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim sa i përket marrëdhënies së huas me shtetasin P.H dhe qëllimin e marrjes së kësaj shume.

38.5.1 Në shqyrtim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ, si dhe nëpërmjet prapësimeve të bëra pas kalimit të barrës së provës me dërgimin e rezultateve të hetimit e, më konkretisht, në vlerësim të qëndrimit të tij se “...kjo hua është shlyer brenda vitit dhe për këtë shkak nuk ka pasur detyrim ta deklaronte...”, trupi gjykues përfundimisht çmon se gjithsesi në rubrikën e deklarimit të pasurive ai ka pasur detyrimin ta pasqyrojë këtë hua si burim krijimi të shumës së dhënë kapar, pra të referonte burimin konkret të kryerjes së këtij investimi. Kështu, në formularin e deklarimit të pasurisë, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë – pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, që i përket deklaratës së interesave privatë të vitit 2010, kërkohet nga deklaruesit që të pasqyrojnë ndryshimet (shtesa dhe pakësime) të ndodhura në interesat pasurore privatë të deklaruar më parë, për çdo lloj pasurie, të luajtshme dhe të paluajtshme, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe burimin e krijimit të pasurisë (në këtë rast të investimit të kryer). Komisioni vëren se në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2010, e cila sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka vlerën e provës në këtë proces, në përmbushje të këtij detyrimi subjekti ka deklaruar si burim krijimi të këtij investimi vetëm të ardhurat e tij vjetore. Për më tepër, trupi gjykues vlerëson se kjo marrëdhënie huaje, pavarësisht se pretendohet si e mbyllur brenda vitit, do të duhej të deklarohet/raportohej nga subjekti i rivlerësimit, kjo në kuptim të verifikimeve që mund të bëheshin nga ILDKPKI-ja, në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

38.6 Në këtë kontekst, Komisioni arrin në përfundimin se edhe shuma 3,000 euro, e pretenduar si e marrë hua nga shtetasi P.H në maj të vitit 2010, nuk do të reflektohet si e ardhur që mund të ketë shërbyer në shlyerjen e kaparit për porositjen e pasurisë nga shoqëria “*** ” sh.p.k.

38.7 Për sa më sipër u arsyetua, si dhe bazuar në deklaramet e bëra nga subjekti në ILDKPKI dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për kryerjen në datën 26.5.2010 të pagesës së kaparit në favor të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë “*** ” sh.p.k., të pasqyruar në tabelën si vijon:

Tabela nr. 1

Analiza e treguesve financiarë në datën 26.5.2010	Vlerat në lekë
A) Pasuri	1 463 020
Apartament banimi me sip. 78.9 m ² , Q , Njësia Administrative D	1 388 100
Ndryshim likuiditeti	74 920
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	1 463 020
D) Të ardhura	548 179
Të ardhura nga paga e subjektit	548 179
E) Shpenzime	54 274
Shpenzime jetike	54 274
Balanca e fondeve (D-C-E)	- 969 115

38.8 Si konkluzion, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer në datën 26.5.2010, për shlyerjen e kaparit për porositjen e apartamentit nga shoqëria “**** ” sh.p.k., duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

39. Së dyti, subjekti ka deklaruar se shuma prej 10,000 euro e paguar për kontratën e kaparit pas revokimit të saj u përdor për pagesën e kryer në datën 19.2.2011 për prenotimin e apartamentit nga shoqëria “**** ” sh.p.k. Në vijim ka referuar se gjatë vitit 2011, krahas kësaj shume, ka paguar vlerën prej 20,000 euro, me burim tri huat e marra nga shtetasit N. L , I.M dhe Z.B, duke sqaruar se huaja e shtetas Z.B është shlyer brenda vitit 2011.

39.1 Edhe në këtë situatë, Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, si dhe me deklaratimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ.

39.2 Sikurse u evidentua edhe më sipër, në DIPP-në e vitit 2011 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim për pagesën e kryer në datën 19.2.2011 për porositjen e apartamentit nga shoqëria “**** ” sh.p.k. kanë shërbyer: (i) të ardhurat e tij vjetore nga paga dhe dietat; (ii) shuma prej 800,000 lekësh nga kredia e marrë në Credins Bank; (iii) shuma prej 200,000 lekësh nga *overdraft*-i; (iv) shuma prej 5,000 euro, hua e marrë nga shtetasi I.M në datën 12.1.2011; (v) shuma prej 5,000 euro, hua e marrë nga shtetasi N. L në datën 20.1.2011.

39.3 Nga hetimi i kryer rezultoi se kredia e marrë në Credins Bank dhe *overdraft*-i i aplikuar po në këtë bankë¹⁵ nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi i kësaj pasurie, pasi kredia në shumën 800,000 lekë është disbursuar në datën 29.7.2011, ndërsa *overdraft*-i nuk është tërhequr deri në datën 19.2.2011 (data e kryerjes së pagesës). Në këto kushte, Komisioni arrin në konkluzionin se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti ka kryer deklaram të pasaktë të burimeve të krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, duke u vendosur në kushtet parashikuara sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

¹⁵ Shkresë e Credins Bank nr. *** prot., datë 16.3.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 18.3.2021).

39.4 Gjithashtu, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar revokimin e kontratës së kaparit në DIPP-në e vitit 2011. Në këto rrethana, si dhe në kushtet kur rezultatet e analizës financiare tregojnë se subjekti nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të kryer pagesën e kaparit në vitin 2010, në vlerën 10,000 euro, në vlerësim përfundimtar për efekt analize edhe kjo shumë nuk do të reflektohet si e ardhur dhe/apo burim për pagesën e kryer në datën 19.2.2011, për prenotimin e pasurisë objekt vlerësimi.

39.5 Komisioni konstaton se vetëm gjatë hetimit administrativ subjekti ka pretenduar se si burim për kryerjen e pagesës prej 30,000 euro në datën 19.2.2011 ka shërbyer edhe një hua e marrë prej tij nga shtetasja Z.B në shumën 10,000 euro, për të cilën referon se e ka shlyer brenda vitit, rrethanë të cilën e konfirmon me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit.

39.6 Në vijim të arsyetimit, Komisioni vlerëson se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, e cila është një deklaratë specifike e plotësuar kryesisht bazuar edhe në përputhje me parashikimet e bëra në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor që krahas deklarimit të pasurisë (në këtë rast të apartamentit në Tiranë) të deklaronte dhe të provonte me dokumentacion justifikues ligjor edhe burimin e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për likuidimin e kësteve për shlyerjen e çmimit të blerjes së saj. Bazuar në pikën 7 të udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së nr. 4095, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin që për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrat me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., të deklaronte burimin në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacion ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të secilës pasuri në momentin e krijimit të tyre.

39.7 Kështu, trupi gjykues në vijim të arsyetimit të tij çmon se, megjithëse subjekti pretendon se kjo hua është shlyer brenda vitit dhe për këtë shkak nuk ka pasur detyrimin ta deklaronte, ai gjithsesi në rubrikën e deklarimit të pasurive të DIPP-së së vitit 2011 ka pasur detyrimin ta deklaronte si burim për pagesën e kryer në favor të shoqërisë “**** ” sh.p.k., pra të referonte burimin konkret të kryerjes së këtij investimi. Për më tepër, vlerësohet se edhe kjo marrëdhënie huaje, pavarësisht se pretendohet si e mbyllur brenda vitit, do të duhej të deklarohet/raportohej nga subjekti i rivlerësimit, kjo edhe në kuptim të verifikimeve që mund të bëheshin nga ILDKPKI-ja, në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

39.8 Sa më sipër, në kushtet kur rezulton se huaja e pretenduar si e marrë nga shtetasja Z.B nuk është deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 dhe as në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, pavarësisht vlerësimit të ligjshmërisë së burimit të të ardhurave të huadhënësit të pretenduar, në analizën financiare kjo shumë nuk do të reflektohet si e ardhur/burim për kryerjen e pagesës nga subjekti në datën 19.2.2011 për prenotimin e pasurisë objekt vlerësimi.

40. Gjithashtu, Komisioni vërejti se subjekti i rivlerësimit parashtroi se si burime krijimi të kësaj pasurie kanë shërbyer edhe dy hua të marra në janar të vitit 2011 nga shtetasit N. L dhe I.M , përkatësisht 5,000 euro secili, para kryerjes së pagesës në favor të shoqërisë “*** ” sh.p.k. Komisioni konstatoi se këto dy hua janë deklaruar në DIPP-në e vitit 2011, por nuk janë deklaruar si burime të krijimit të pasurisë objekt vlerësimi në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në këto kushte, duke i dhënë deklaratës periodike vjetore fuqi provuese për efekt të këtij procesi, në përputhje me nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti gjatë hetimit administrativ, trupi gjyqës çmoi të pranojë se si burim krijimi të pasurisë objekt vlerësimi mund të kenë shërbyer vlerat monetare të referuara si të marra hua nga shtetasit e sipërcituar. Por, nga ana tjetër, pranimi i kësaj rrethane e çon Komisionin në konstatimin se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti ka kryer deklaram të pasaktë të burimeve të krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, duke u vendosur në kushtet e parashikuara sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

41. Në vijim të analizës së kryer për këto dy marrëdhënie huaje, Komisioni vlerëson se shtetasit e sipërcituar (huadhënësit e deklaruar) kategorizohen në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, në përputhje me pikën 14 të nenit 3 dhe pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive e, në këtë rast, burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumave të deklaruara si të dhëna hua në favor të subjektit të rivlerësimit.

41.1 Pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti mbi të ardhurat e personave të tjerë të lidhur, Komisioni konstatoi se shtetasi N. L në datën 30.8.2010 ka përfituar të ardhura nga shitja e një pasurie¹⁶ të llojit apartament banimi në bashkëpronësi, në vlerën 5,594,655 lekë, ku ai zotëronte 1/3 pjesë takuese, të cilat duken të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht huan e dhënë në favor të subjektit.

41.2 Ndërsa, sa i përket shtetasit I.M , gjatë hetimit administrativ subjekti ka depozituar disa dokumente, të cilat tregojnë se ky shtetas ka ushtruar aktivitet tregtar në qytetin e Bajram Currit, në fushën e shitjes së artikujve të ndryshëm, punime druri, por se nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor, ku të evidentohen të ardhura të përfituara prej këtij shtetasi nga ky aktivitet. Edhe pas kalimit të barrës së provës mbi këtë konstatim, Komisioni vëren se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të ardhura të përfituara nga shtetasi I.M , të cilat të mundësonin dhënien hua prej tij në janar të vitit 2011 të shumës 5,000 euro.

42. Për sa më sipër u arsyetua, si dhe bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për kryerjen në datën 19.2.2011 të pagesës për porositjen e pasurisë nga shoqëria “*** ” sh.p.k., të pasqyruar në tabelën si vijon:

¹⁶ Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. ***, subjekti ka depozituar dokumentin kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.8.2010, redaktuar nga noteri publik, znj. M.Sh.

Tabela nr. 2

Analiza e tregesve financiarë në datën 19.2.2011	Vlerat në lekë
A) Pasuri	4 415 112
Apartament me sip. 91.4 m ² , ndodhur në Q , Njësia Administrative D	4 149 000
Ndryshim likuiditeti	266 112
B) Detyrime	691 500
Hua e marrë nga shtetasi I.M , datë 12.1.2011	-
Hua e marrë nga shtetasi N. L , datë 20.1.2011	691 500
C) PASURI NETO (A-B)	3 723 612
D) TË ARDHURA	154 427
Të ardhura nga paga e subjektit	154 427
E) SHPENZIME	18 341
Shpenzime jetike	18 341
Balanca e fondeve (D-C-E)	- 3 587 526

43. Referuar rezultateve të kësaj analize financiare, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer në datën 19.2.2011 për porositjen e apartamentit nga shoqëria “****” sh.p.k., duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

44. Si konkluzion, në vlerësimin tërësor të kësaj pasurie, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të kësaj pasurie, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për krijimin e saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Pasuri e deklaruar veçmas nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, znj. S.L

45. Pasuria e llojit likuiditete në gjendje *cash*, në shumën 1,000,000 lekë, me burim krijimi kursimet nga veprimtaria si avokate dhe dhuratat e njerëzve të afërt.

45.1 Komisioni konstaton se në seksionin “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike” të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, personi i lidhur duket se ka deklaruar: (i) shumën 1,657,428 lekë si të ardhura të përfituara nga puna e saj si avokate, duke sqaruar se nga maji i vitit 2012 deri në shtator të vitit 2013 ka qenë e punësuar si avokate pranë subjektit “ ***”, me pagë mujore neto 19,536 lekë dhe se nga data 1.1.2014 e deri në momentin e deklaramit ka qenë e vetëpunësuar (privat) si avokate, person fizik, me NIPT *** (referon se sipas bilanceve ka përfituar nga aktiviteti i avokatisë shumën 1,657,428 lekë); (ii) shumën 500,000 lekë si dhuratë martese nga prindërit dhe të afërmit e saj.

Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

46. Mbetet i paqartë deklarimi i bashkëshortes së subjektit nëse shuma prej 1,000,000 lekësh e deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 janë vetëm të ardhura të përfituara deri në këtë vit apo gjithashtu kjo shumë gjendej edhe *cash* në banesë.

47. Mungon dokumentacioni ligjor për të ardhurat e deklaruara në formë dhurate nga prindërit dhe të afërmit.

Analiza/verifikimet e kryera nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

48. Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë ndër vite në ILDKPKI të depozituara nga bashkëjetuesja e më pas bashkëshortja e subjektit (deklarata e pasurive veçmas në cilësinë e personit të lidhur që mbart detyrimin për deklarim), nuk rezulton të jetë

deklaruar prej saj disponim pasurie në formë likuiditetesh *cash*. Nga ana tjetër, rezulton se në DIPP-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit likuiditete në gjendje *cash*, në shumën 300,000 lekë, ndërsa në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar pakësimin plotësisht të kësaj vlere monetare. Gjithashtu, Komisioni konstaton se në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara ndër vite në ILDKPKI, personi i lidhur nuk ka deklaruar vlera monetare të dhuruara në vite as në vitin 2015, evidentuar si viti i lidhjes së martesës ligjore me subjektin.

49. Gjatë hetimit administrativ, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se kjo shumë, e cila është deklaruar në deklaratën *Vetting* si pasuri, përbën edhe të ardhurat ndër vite të kursyera dhe të deklaruara në DIPP-në e vitit 2014 (depozituar në datën 20.3.2015), që i përket vitit të deklarimit kur shtetasja S.L është përfshirë si person i lidhur. Subjekti ka pretenduar se fakti që kjo shumë e gjendjes *cash* prej 1,000,000 lekësh është deklaruar në rubrikën e të ardhurave në deklaratën e dorëzuar në datën 20.3.2015 dhe jo në rubrikën e pasurive (sikurse është deklaruar në deklaratën *Vetting*), është si pasojë e një lapsusi dhe e paqartësisë së personit të lidhur, sa i përket rubrikës ku duhet të deklarohej kjo shumë. Sipas subjektit, deklarimi i vitit 2015, duke qenë edhe deklarimi i parë i saj, ka qenë më i përgjithshëm dhe jo shumë i detajuar, për shkak të mungesës së eksperiencës së personit të lidhur në deklarime. Subjekti referon se në deklaratën vijuese të dorëzuar në datën 20.3.2016, në të cilën përshkruhen vetëm ndryshimet e pasurisë dhe të ardhurat për periudhën 1.11.2015 – 31.12.2015, janë deklaruar vetëm të ardhurat nga puna si avokate për atë vit dhe nuk është përshkruar gjendja *cash*, e cila duke qenë se ka mbetur e pandryshuar nuk është pasqyruar në deklaratën periodike. Në deklaratën *Vetting*, e plotësuar në vitin 2017, pra në vitin e tretë të deklarimit të personit të lidhur, deklarata ka qenë më e detajuar dhe plotësimi i saj është kryer në mënyrë më të kujdesshme.

49.1 Vërehet se, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, si dhe me shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i ka qëndruar deklarimeve të bëra gjatë hetimit administrativ mbi pasqyrimin e likuiditeteve *cash* nga ana e personit të lidhur.

50. Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2014, në seksionin “Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, personi i lidhur ka deklaruar shumën 1,000,000 lekë, me burim të ardhurat nga puna si avokate dhe të tjera ndër vite.

50.1 Në shqyrtim përfundimtar të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, Komisioni vëren se ai pretendon se kjo vlerë e deklaruar në seksionin e të ardhurave ka shërbyer si burim për krijimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* të deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Pra, ai referon se si burim për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi kanë shërbyer të ardhurat e personit të lidhur të përfituara deri në datën 31.12.2014.

51. Nga ana tjetër, rezulton se në DIPP-në e vitit 2014 personi i lidhur nuk ka deklaruar si pasuri të krijuar veçmas prej saj gjendje në likuiditete *cash*. Gjithashtu, sikurse u evidentua më sipër edhe në deklaratat vijuese të depozituara në ILDKPKI (DIPP-të e viteve 2015 dhe 2016), personi i lidhur nuk ka deklaruar shtesa likuiditetesh *cash*. Rezultoi se subjekti ka deklaruar shtesë likuiditetesh për vitin 2015 në seksionin përkatës të deklarimit të pasurive, shumë të cilën referon se e pakëson plotësisht në vitin 2016.

52. Lidhur me deklarimin e likuiditeteve, referuar nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjektet detyrohen të deklarojnë vlerën e

likuiditeteve, gjendje cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj, si dhe burimin e krijimit të tyre.

52.1 Në formularët e deklaramit të pasurisë, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë – pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, që i përket deklaratës së interesave privatë të vitit 2014, kërkohet nga deklaruesit që të pasqyrojnë ndryshimet (shtesa dhe pakësime) e ndodhura në interesat pasurorë privatë të deklaruar më parë, për çdo lloj pasurie, të luajtshme dhe të paluajtshme, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklaramit.

52.2 Por, nga ana tjetër, rezulton se në DIPP-në e vitit 2014 bashkëshortja e subjektit ka bërë deklaramin fillestar të pasurisë, çka do të thotë se në përputhje me nenin 4, shkronja “d” dhe nenet 21 e 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ka pasur detyrimin të deklaronte pasurinë që zotëronte veçmas nga subjekti i rivlerësimit dhe burimin e krijimit të saj.

52.3 Si rrjedhim, trupi gjykues vlerëson se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, në cilësinë e subjektit që mbart detyrimin për deklaram, ka pasur detyrimin të deklaronte saktë dhe në rubrikën përkatëse gjendjen e pasurisë në formë likuiditetesh *cash*. Në vijim të arsytimit, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mënyrën e të kuptuarit të personit të lidhur në deklaramin e likuiditeteve për vitin 2014 është jo vetëm në kundërshtim me ligjin, por edhe një pretendim alogjik.

53. Si përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm apo të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe se përfundimisht do vlerësohet se si burim për krijimin e shumës 1,000,000 lekë, të pasqyruar si pasuri e llojit likuiditete *cash* nga personi i lidhur në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, mund të kenë shërbyer vetëm të ardhurat e tyre të përfituara në janar të vitit 2017, para dorëzimit të kësaj deklarate.

54. Komisioni konstaton se të ardhurat e përfituara nga subjekti dhe personi i lidhur në janar të vitit 2017 nuk janë të mjaftueshme për të mundur krijimin e kursimeve në formë likuiditetesh *cash* në shumën 1,000,000 lekë deri në datën 26.1.2017 (data e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*), duke bërë që subjekti të gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Gjetje/çështje të tjera (automjeti në përdorim e disponim)

55. Në përgjigjet e pyetësorit standard nr. *** të dërguar nga Komisioni, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se *ka përdorur automjetin me targë AA *** për të udhëtuar drejt Republikës së Kosovës, i cili së fundmi ka qenë në pronësi të shtetasit B.Gj.D (referuar si kushëri i parë).*

56. Nga verifikimi i dokumentacionit shkresor të administruar në dosje lidhur me këtë pasuri¹⁷, Komisioni konstaton se: (i) në datën 29.5.2015, shtetasi A.L e ka blerë¹⁸ këtë automjet (***, vit prodhimi 2003) kundrejt çmimit 450,000 lekë; (ii) në datën 1.6.2015, shtetasi A.L është pajisur

¹⁷ (i) Shkresë e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 8.11.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.11.2023); (ii) shkresë e noterit publik, z. K.M, e datës 11.10.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 13.10.2023; (iii) shkresë e AMF-së nr. *** prot., datë 9.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.2.2021).

¹⁸ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.5.2015, redaktuar nga noteri publik, znj. Sh.Gj.

me certifikatën e pronësisë për këtë automjet (targuar AA ***) dhe ka lidhur një policë sigurimi të detyrueshëm (TPL), në të cilën figuron i shënuar emri i subjektit të rivlerësimit si “përdorues”.

56.1 Në vijim rezulton se në datën 10.7.2015 shtetasi A.L ka nënshkruar një prokurë të posaçme, në referim të së cilës ka emëruar subjektin e rivlerësimit si përfaqësues të posaçëm, duke i dhënë tagrat për ta përfaqësuar pranë autoriteteve doganore dhe Drejtorisë së Transportit Rrugor për kryerjen e veprimeve që lidhen me këtë automjet, për ta përfaqësuar në çdo zyrë noteriale për nënshkrimin e kontratave të tjetërsimit në favorin e vetë subjektit ose palëve të treta (me ose pa kundërshpërblim), si dhe të drejtën për ta drejtuar/përdorur automjetin me targë AA *** brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pa afat kohor të përcaktuar.

57. Referuar të dhënave të përfituara nga sistemi TIMS¹⁹, duket se në vitin 2015 subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar dy herë jashtë vendit me këtë automjet, konkretisht në datat 18.7.2015 dhe 8.12.2015.

58. Rezulton se në datën 22.8.2016 subjekti i rivlerësimit (si përfaqësues me prokurë i shtetasit A.L) ia ka shitur²⁰ këtë automjet shtetasit B.D (referuar/evidentuar si djali i tezes së subjektit) kundrejt çmimit 2,500 euro. Në datën 31.8.2016, shtetasi B.D është pajisur me certifikatën e pronësisë dhe se në datën 9.6.2017 ka lidhur një policë sigurimi të detyrueshme (TPL) për këtë automjet, në të cilën sërish subjekti i rivlerësimit figuron i shënuar si “përdorues”.

59. Në vijim të verifikimit të të dhënave të përfituara nga sistemi TIMS, evidentohet se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar jashtë vendit me këtë automjet edhe në datën 30.7.2017.

60. I pyetur nga Komisioni²¹ mbi periudhën gjatë së cilës ai dhe/apo familjarët e tij kanë pasur në përdorim automjetin e sipërcituar, si dhe mbi rrethanat e tjera të evidentuara lidhur me këtë pasuri²², ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se këtë automjet e ka përdorur me raste të caktuara (disa herë) dhe jo në mënyrë të vazhdueshme brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Sa i përket shtetasit A.L, deklaroi se ka marrëdhënie shoqërore me të dhe se e ka njohur në mënyrë rastësore në kohën kur ushtronte detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Referon se ai është me profesion jurist dhe se për periudhën 2014 – 2016 ka ushtruar profesionin e avokatit në Tiranë, por duke theksuar se njohja e tij me të në Elbasan nuk ka ardhur për shkak të cilësisë si avokat, por si jurist i atashuar pranë zyrës së noterisë së motrës së tij, znj. A.L (në qytetin e Elbasanit). Në lidhje me faktin e shënimit të emrit të tij në policën e sigurimit të datës 1.6.2015, deklaroi se fillimisht nuk ka qenë në dijeni dhe se pasqyrimi i këtij shënimi është kryer nga shtetasi A.L në mënyrë të njëanshme, nisur nga fakti se i kishte parashtruar kërkesën për përdorimin e një automjeti jashtë vendit, konkretisht në Republikën e Kosovës, përpara se ai ta blinte këtë automjet. Subjekti deklaroi se shtetasi A.L i ka sqaruar se policën e sigurimit e ka prerë edhe në emrin e tij, me qëllim mbulimin e shpenzimeve nga kompania e sigurimit edhe në eventualitetin e përfshirjes së automjetit në aksident, gjatë kohës që drejtohej prej tij. Në vijim referon se, në dijeninë e tij, sipas kuadrit ligjor në fuqi, një mjet nuk mund të përdoret jashtë Republikës së Shqipërisë nëse përdoruesi

¹⁹ Shkresë e DPPSH-së nr. *** prot., datë 5.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 5.2.2021).

²⁰ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.8.2016, redaktuar nga noteri publik, z. K.M.

²¹ Pyetja nr. *** e pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

²² (i) Faktin e shënimit të emrit të tij si “përdorues” në policat e sigurimit TPL; (ii) mbi marrëdhënien e tij me shtetasin A.L dhe mbi faktin e lëshimit të prokurës së posaçme nga ky shtetas, e cila i jep tagra të plota mbi këtë pasuri; (iii) mbi përdorimin i këtij automjeti në vazhdimësi prej tij edhe pas ndërrimit të pronarit etj.

nuk pajisej me policë sigurimi. Në lidhje me faktin e evidentuar se në prokurën e posaçme i është dhënë edhe tagri i disponimit përveç atij të përdorimit, deklaroi se fillimisht kjo rrethanë nuk është konstatuar prej tij, pasi nuk e ka lexuar prokurën në detaje lidhur me tagrat e dhënë nga i përfaqësuari, duke pretenduar se është vënë në dijeni të këtij fakti vetëm pas kërkesës së pronarit A.L për ta shitur automjetin tek blerësi B.D . Gjithashtu, referon se as pronari i automjetit nuk e ka vënë re fillimisht këtë rrethanë të përcaktuar në prokurën e posaçme, duke pretenduar se ajo ka qenë standarde, model i njëjtë si për raste të tjera, sipas praktikës së konsoliduar të noterëve në redaktimin e këtyre dokumenteve noteriale. Më tej, subjekti ka deklaruar se në kohën që do të kryhej kontrata e shitjes, blerësi B.D (djali i tezës), banues në Lezhë, i ka kërkuar që shtetasi A.L të vijë në Lezhë apo Laç për të lidhur kontratën e shitjes. Pas komunikimit me shtetasin A.L , pasi ai ka verifikuar edhe një herë prokurën, në kushtet e mirëbesimit i ka kërkuar që kontratën e shitjes me shtetasin B.D ta nënshkruante ai në cilësinë e përfaqësuesit të tij, meqenëse sipas tagrave të përcaktuar në prokurë (të cilën ai e verifikoi) i përfaqësuari kishte të drejtë edhe ta shiste automjetin. Në lidhje me kushtet e kontratës së shitjes, deklaroi se shitësi dhe blerësi janë dakordësuar me njëri-tjetrin dhe se çmimi i shitjes është paguar nga blerësi jashtë zyrës noteriale edhe pa praninë e tij. Në lidhje me faktin se përse pronari i mjetit A.L nuk është paraqitur personalisht për të lidhur kontratën e shitblerjes, shpjegon se ka qenë vullneti i këtij shtetasi që ky veprim juridik të kryhej nga ana e tij dhe për shkak se në atë ditë kishte disa angazhime shtesë në zyrën e noterisë ku ai ishte i punësuar. Subjekti ka deklaruar se nisur nga fakti se shtetasi A.L i kishte lënë përdorim pa kundërshtim këtë automjet në raste të caktuara, në vlerësimin e tij nuk ishte racionale që të refuzonte nënshkrimin e kontratës në emër e për llogari të tij, duke vënë në diskutim mirëbesimin e ndërsjellë. Nga ana tjetër, duke qenë se lidhur me kushtet e kontratës palët ishin dakordësuar me njëri-tjetrin, si dhe nuk kishte pengesa ligjore për kryerjen e këtij veprimi juridik në emër dhe për llogari të tij, ka nënshkruar kontratën e shitblerjes së automjetit tip “****”, me targë AA ***. Rithekson se pagesa e çmimit të shitjes është kryer jashtë zyrës së noterit dhe se shitësi A.L e ka marrë *cash* pagesën për automjetin nga shtetasi B.D . Subjekti evidenton faktin se shtetasi B.D e ka blerë këtë automjet në datën 22.8.2016, duke referuar se ai e ka përdorur sërish për të udhëtuar drejt Republikës së Kosovës me bashkëshorten në datën 30.7.2017 dhe se për shkak të planifikimit të këtij udhëtimi është lidhur kontrata e sigurimit, ku në policën e sigurimit figuron i pasqyruar edhe emri i tij. Në përfundim, subjekti i rivlerësimin rithekson se ky automjet nuk ka qenë në përdorim të vazhdueshëm prej tij, por sa herë ka pasur nevojë të udhëtonte në rrugë të gjata brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë e ka përdorur atë.

60.1 Në mbështetje të deklarimeve të tij, ndër të tjera, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale datë 29.1.2024²³ të shtetasit A.L , në referim të së cilës ky shtetas ka deklaruar se i ka shitur automjetin me targë AA *** shtetasit B.D , ku çmimin e shitjes prej 2,500 euro e ka marrë nga ky shtetas jashtë zyrës noteriale dhe në lidhje me këtë veprim nuk ka asnjë pretendim ligjor apo financiar. Duke qenë se në maj të vitit 2016 ka filluar punë në zyrë noterie dhe ishin muajt e parë të aktivitetit, nuk ka mundur të shkëputet dhe është realizuar kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.8.2016, pranë noterit K.M , me zyrë në Laç, nëpërmjet përfaqësimit me prokurën e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., të noterës M.E .

²³ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.1.2024.

60.2 Ndërkohë, Komisioni vëren se në kontratën e shitblerjes së datës 22.8.2016 referohet se përfaqësuesi i palës shitëse (subjekti i rivlerësimit) i deklaroi noterit se këtë automjet ia ka shitur palës blerëse në çmimin 2,500 euro, shumë të cilën e ka tërhequr plotësisht *cash* nga pala blerëse jashtë kësaj zyre, në ditën e përpilimit të aktit. Gjithashtu deklaroi se po në ditën e përpilimit të aktit i ka dorëzuar automjetin palës blerëse.

61. Pra, duket se ka mospërputhje mes deklaramëve nga subjekti dhe shtetasi A.L me përcaktimet e bëra në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie, sa i përket marrjes së vlerës prej 2,500 euro nga blerësi. Kështu, gjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar se kjo shumë është marrë nga shtetasi A.L para nënshkrimit të kontratës, ndërkohë në kontratë – bazuar në deklaramet e bëra në cilësinë e përfaqësuesit të palës shitëse – është referuar se shuma është marrë *cash* prej tij.

62. Gjithashtu, duket se sendi – automjeti objekt transaksioni – ka qenë në përdorim të subjektit edhe në ditën e nënshkrimit të kontratës së shitjes në datën 22.8.2016, për sa kohë në këtë kontratë referohet se vetë subjekti ka deklaruar se ia ka dorëzuar automjetin shitësit (djalit të tezes së tij) në ditën e përpilimit të aktit të shitjes, marrë në konsideratë këtu edhe faktin se ky akt është nënshkruar në një zyrë noterie në qytetin e Laçit.

63. Nga ana tjetër, nga analizimi dhe shqyrtimi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ mbetet e paqartë marrëdhënia e tij me shtetasin A.L dhe duket se ka kontradikta në deklaramet e tij, kjo në kushtet kur subjekti deklaroi se e ka njohur atë në mënyrë rastësore, jo si avokat, por si jurist i atashuar pranë zyrës së noterisë së motrës së tij, znj. A. L, por nga ana tjetër rezulton se ky shtetas ka filluar punë në zyrën noteriale të motrës së tij në maj të vitit 2016, ndërsa subjekti e ka marrë në përdorim këtë automjet përpara kësaj periudhe. Po ashtu, megjithëse deklaroi se e ka njohur si jurist te zyra noteriale e shtetasit A.L, subjekti nuk ka sqaruar marrëdhënien e tij me këtë zyrë noteriale dhe/apo noterin publik përkatës.

64. Referuar të dhënave të përfituara nga sistemi TIMS, duket se ky automjet nuk është përdorur asnjëherë nga pronarët e tij *de jure* për udhëtime jashtë vendit. Për më tepër, në vijim të verifikimeve të kryera në sistemin TIMS dhe atë të AMF-së²⁴, rezulton se në periudhën që ka pasur në pronësi këtë automjet, shtetasi B.D ka bërë disa hyrje-dalje në pikën kufitare të Morinës me automjete të tjera, njëri nga të cilët duket se është në pronësi të tij, një tjetër në pronësi të babait të tij dhe automjetet e tjera në pronësi të shtetasve të tjerë. Por, siç u evidentua edhe më sipër, në asnjë rast nuk ka kaluar pikën kufitare me automjetin e blerë nga shtetasi A.L, përfaqësuar me prokurë nga subjekti i rivlerësimit.

65. Sa më sipër, duket se në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* (datë 26.1.2017) subjekti i rivlerësimit e ka pasur në përdorim automjetin në fjalë, pasi ka pasur policia sigurimi të vlefshme, në të cilat ai shënohet si “përdorues”, si dhe evidentohen udhëtime të kryera prej tij jashtë vendit, para dhe pas dorëzimit të kësaj të kësaj deklarate, por se nuk e ka deklaruar përdorimin e kësaj pasurie, në shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

²⁴ Agjencia e Mbikëqyrjes Financiare.

66. Nga ana tjetër, në kushtet kur subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri të luajtshme në përdorim në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, si dhe në konsideratë të faktit, nga ku duket se ka pasur tagra të plotë mbi këtë automjet dhe e ka përdorur në mënyrë të vazhdueshme, madje edhe pasi ka ndryshuar pronësia (pronari), Komisioni ngre dyshime të arsyeshme se kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të subjektit.

67. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi dy konstatimet e bëra si më sipër në verifikimin e pasurisë automjet tip “****”, me targë AA ***.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

68. Me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit paraqiti argumentet e tij dhe depozitoi prova të reja shtesë mbi gjetjet/konstatimet e bëra nga Komisioni në lidhje me këtë pasuri, duke parashtruar si vijon:

69. Në lidhje me shitjen e kësaj pasurie prej tij, referon se çmimi i shitjes së automjetit është marrë *cash* paraprakisht nga shtetasi A.L . Në momentin e nënshkrimit të kontratës, noterit i është bërë me dije që palët nuk kanë pretendime për pagesën e çmimit të shitjes edhe në lidhje me dorëzimin e automjetit. Deklaron se nuk i ka kushtuar rëndësi apo verifikuar përmbajtjen e kontratës, duke prezumuar paraqitjen e të dhënave të sakta, pasi vetë natyra e kësaj kontrate dhe rrethanat nuk e nxisnin të kryejë verifikim të detajuar në lidhje me tekstin e saj. Sipas subjektit, formulimi i kontratës është bërë nga noteri sipas praktikës apo modeleve të mëparshme të përpiluara prej tij për këto lloj aktesh noteriale²⁵. Nga mënyra e formulimit të kontratës dukshëm provohet se qëllimi i noterit është të pasqyrojë faktin që është paguar çmimi i shitjes përpara hartimit të aktit noterial dhe se ndërmjet palëve nuk ka asnjë pretendim lidhur me këtë fakt. Si përfundim, në lidhje me këtë rrethanë subjekti deklaron se në rastin konkret gjendja e faktit është ajo e deklaruar në deklaratën noteriale të shtetasit A.L , se paratë janë marrë prej tij përpara se të lidhej kontrata e shitjes.

70. Sa i përket marrëdhënies me shtetasin A.L , rithekson se, sikurse ka deklaruar më parë, ky shtetas është me profesion jurist dhe sipas shpjegimit të tij është diplomuar në vitin 2008. Referon se nga viti 2010 deri në shkurt të vitit 2014 ka ushtruar aktivitetin si avokat në Tiranë e në vijim ka filluar përsëri ushtrimin e aktivitetit të tij si avokat prej tetorit 2014 deri në korrik 2016. Gjatë kohës që ushtronte detyrën e avokatit në Tiranë qëndronte të shumtën e kohës në Elbasan, pasi motra e tij A.L ushtronte profesionin e noteres në këtë qytet. Sipas shpjegimeve që i ka dhënë shtetasi A.L gjatë kohës që ka ushtruar detyrën e avokatit, ky i fundit kryente veprimet juridike në emër dhe për llogari të motrës së tij, notere në institucionet publike, në varësi të veprimeve noteriale të redaktuara prej saj.

70.1 Për të provuar këtë fakt, ka paraqitur dokumentin prokurë e përgjithshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.8.2012, ku shtetasi A.L është caktuar si përfaqësues i motrës së tij A.L, në cilësinë e avokatit, duke pasqyruar në prokurë të dhënat profesionale të tij, numër licence dhe NIPT. Sipas tagrave të përcaktuar në prokurë, shtetasi A.L ka pasur të drejtë të kryejë në emër dhe për llogari të saj veprime juridike përpara institucioneve të ndryshme, palë të treta në procese gjyqësore.

²⁵ Në mbështetje të prapësimeve të tij ka depozituar disa akte noteriale të redaktuara nga noteri publik, z. K. M, në lidhje me transaksione të kryera për shitblerje automjetesh në periudhë të afërt me kontratën e shitblerjes së automjetit me targë AA *** (datë 22.8.2016), në të cilën subjekti shfaqet si përfaqësues i palës shitëse.

70.2 Në vijim, subjekti shpjegon se në këtë cilësi marrëdhënia juridike e përfaqësimit me motrën e tij dhe palëve të treta nuk ka filluar me anë të punësimit të tij si jurist apo sekretar pranë zyrës së noterisë së shtetases A.L, konkretisht në datën 1.5.2016 si asistent zyre, por të paktën që në datën 10.8.2012, kur është lëshuar edhe prokura e përgjithshme. Pra, për shkak të kësaj cilësie ai qëndronte zakonisht në zyrën e noterisë në Elbasan, pasi të gjitha veprimet juridike që duhet të kryente noterja kryheshin prej tij.

70.3 Gjithashtu, subjekti evidenton faktin se shtetasi A.L është autorizuar si përfaqësues i së motrës së tij, notere A.L, pranë QKB-së, për paraqitje dokumentacioni dhe çregjistrimin e aktivitetit privat, rrethanë që provohet me prokurën e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.5.2016, përpara noteres F. K në Elbasan (depozituar në QKB).

70.4 Sa më lart, sipas subjektit rezulton më se e qartë se për shkak të cilësisë së shtetasit A.L si përfaqësues i saj, ai ka qëndruar të shumtën e kohës pranë zyrës së noterisë të motrës së tij dhe është prezantuar si përfaqësues i saj edhe përpara institucioneve shtetërore.

71. Subjekti ka deklaruar se me shtetasen A.L nuk ka pasur asnjë marrëdhënie juridike, nuk e ka pasur person nën hetim apo të ketë qenë palë në ndonjë proces gjyqësor me person nën hetim, të pandehur apo me kërkesë në fazën e ekzekutimit shtetasen e sipërcituar²⁶.

72. Për shtetasin A.L deklaroi se gjatë kohës që ka pasur në pronësi këtë automjet ka dalë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm nga pika e kalimit kufitar në Rinas. Ndërsa për shtetasin B.D sqaron se gjatë kohës që ka pasur në pronësi këtë automjet ka dalë nga Republika e Shqipërisë me automjete të tjera, të tij dhe familjarëve të tij, kryesisht me makina më komode e të sigurta dhe më të reja në prodhim. Referon se shtetasi B.D , babai dhe vëllezërit e tij zotërojnë automjete shumë herë më komode se automjeti me targë AA ***, të cilat i kanë përdorur në udhëtime të gjata jashtë Republikës së Shqipërisë. Ndërsa automjetin me targë AA *** shtetasi B.D e përdorte kryesisht për lëvizjet brenda qytetit të Lezhës nga ai vetë apo bashkëshortja²⁷.

73. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka evidentuar faktin se nuk ka pasur policë sigurimi të vlefshme në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, në të cilën ai është shënuar si “përdorues”, për rrjedhojë pretendon që nuk e ka pasur në përdorim këtë automjet në momentin e dorëzimit të kësaj deklarate. Për pasojë, parashtron se nuk ka pasur detyrim ligjor për deklarimin e përdorimit të këtij automjeti.

74. Në lidhje me dyshimet e ngritura nga Komisioni se kemi të bëjmë me pasuri të fshehur, subjekti e kundërshton këtë konstatim, duke argumentuar si vijon:

74.1 *Së pari*, rezulton e provuar se shtetasi A.L ka pasur të ardhura për blerjen e automjetit me vlerë 450,000 lekë²⁸.

²⁶ Në mbështetje të deklaramëve të tij ka depozituar si provë shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me nr. *** prot., datë 12.3.2024.

²⁷ Më dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, në mbështetje të shpjegimeve të tij, ka depozituar si provë të re deklaratën noteriale të shtetasit B.D, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.3.2024, redaktuar nga noteri publik, z. F.B.

²⁸ Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e shtetasit A.L.

74.2 *Së dyti*, rezulton e provuar se shtetasi B.D ka pasur të ardhura për blerjen e automjetit me vlerë 2,500 euro²⁹.

74.3 *Së treti*, ai dhe bashkëshortja e tij kanë pasur të ardhura për blerjen e këtij automjeti, por nuk ka qenë në preferencat e tij blerja dhe pasja në pronësi e një automjeti të tillë, por është përdorur vetëm për shkak të nevojës për të udhëtuar jashtë Republikës së Shqipërisë.

74.4 *Së katërti*, fshehja e pasurisë sipas nenit 257/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë përbën vepër penale dhe do të ishte jashtë çdo logjike dhe imagjinate të një magjistrati që të rrezikojë karrierën e tij për një automjet me vlerë të tillë, në kushtet kur kishte të ardhura nga burime të ligjshme për krijimin e një pasurie.

74.5 *Së pesti*, nëse ky automjet do të ishte në pronësinë e tij dhe do të kishte pasur qëllim ta fshinte atë, në asnjë rrethanë nuk mund të dilte vetë si palë përfaqësuese në kontratë. Ka vlerësuar se ishte në transparencë të plotë dhe i qetë në ndërgjegje dhe se po vepronte në përputhje me ligjin. Për këtë arsye ka nënshkruar një kontratë në emër dhe për llogari të shtetasit A.L .

74.6 *Së gjashti*, ky automjet është blerë në datën 29.5.2015 nga shtetasi A.L dhe të gjitha taksat dhe detyrimet ligjore për këtë automjet janë përmbushur nga ky shtetas.

74.7 *Së shtati*, shtetasi B.D ia ka shitur këtë automjet një personi të tretë, në datën 22.6.2020.

74.8 *Së teti*, në lidhje me automjetin tip “****” me targë AA **** deklaroi se të gjitha detyrimet pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor janë kryer nga pronari i saj, z. B.D. Ky fakt provohet edhe me vërtetimin nr. ***, datë 29.1.2025, lëshuar nga DRSHTRR Laç.

74.9 *Së nënti*, fakti se në prokurën e datës 10.7.2015 janë përcaktuar tagra disponimi të mjetit, nuk lidhen me qëllimin e pronarit të mjetit A.L për delegimin e të drejtës së shitjes, por sikurse ka shpjeguar edhe në përgjigje të pyetësorit nr. **** prokura përfaqëson një model standard, që ndeshet në praktikën e përditshme të noterëve (në përgjigje të pyetësorit nr. *** janë paraqitur modelet e prokurave nga noterë të ndryshëm).

74.10 *Së dhjeti*, shitja e automjetit nga shtetasi A.L lidhet me mungesën e nevojës së tij dhe të motrës A.L për pasjen në pronësi të dy automjeteve, pas transferimit të aktivitetit të zyrës së noterisë nga Elbasani në Tiranë.

74.11 *Së fundmi*, në praktikën e tij, Komisioni ka konsideruar të besueshëm dhe ka vlerësuar se subjekti ka përmbysur barrën e provës për dyshimin për fshehjen e një automjeti, duke arritur të sjellë prova se subjekti dhe babai i tij kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e automjetit. (shihni vendimin nr. 193, datë 6.9.2019, të Komisionit, faqja 10). Gjithashtu, Komisioni në vendimin nr. 176, datë 8.7.2019 (faqja 19), është shprehur se: “*Provohet se: (i) pronar i ligjshëm i automjetit është z. H. M.; (ii) provohet lidhja e tij, i cili është vëllai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit; (iii) taksat për këtë automjet janë paguar nga pronari i mjetit, z. H. M., fakte të cilat ezauruan çdo dyshim në lidhje me pronësinë e këtij automjeti*”.

²⁹ Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e shtetasit B.D.

75. Për sa ka parashtruar më sipër, subjekti kërkon nga Komisioni që të mbajë në konsideratë dhe të vlerësojë rrethanat e faktit në përputhje me qëllimin e ligjit, që është gjurmimi i pasurive të cilat fshihen nga subjektet për shkak të pamundësisë së justifikimit të burimit të krijimit të tyre. Në rastin konkret, subjekti referon se është deduksion logjik se një pasuri për të cilën ka mundësi financiare ta blejë, nuk ka arsye të mendohet se po fshihet.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit/analiza e provave dhe e ligjit të zbatueshëm

76. Pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit mbi konstatimet e bëra në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi, automjetin tip “****” me targë AA ***, trupi gjykues argumenton si vijon:

77. Sa i përket pretendimit të subjektit se në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* nuk ka pasur policë sigurimi të vlefshme në të cilën të jetë i shënuar emri i tij si “përdorues”, Komisioni vëren se nga verifikimi në sistemin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Financiare gjithsesi rezulton se ky automjet nuk ka pasur policë sigurimi të detyrueshme TPL, të vlefshme për atë periudhë. Pra, rezulton se në dy policat e sigurimit të detyrueshme TPL, të prera për këtë automjet në periudha gjatë të cilave figurojnë pronarë të ndryshëm *de jure*, para dhe pas dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti figuron i shënuar si “përdorues”. Kështu, ka rezultuar se në datën që është lëshuar certifikata e pronësisë në emër të shtetasit A.L për këtë automjet (1.6.2015), ky i fundit është pajisur me policë sigurimi të detyrueshme (TPL), në të cilën figuron i shënuar emri i subjektit të rivlerësimit si “përdorues”. Po ashtu, rezulton se në policën e parë të sigurimit të detyrueshme të lëshuar për këtë automjet (datë 9.6.2017), pasi kishte kaluar në pronësi të shtetasit B.D , figuron i shënuar emri i subjektit të rivlerësimit si “përdorues”.

77.1 Gjithashtu, Komisioni vlerëson se nuk qëndron pretendimi i subjektit se i është shënuar emri në policat e sigurimit si “përdorues” me qëllim mbulimin e shpenzimeve nga kompania e sigurimit edhe në eventualitetin e përfshirjes së automjetit në aksident, gjatë kohës që drejtohej prej tij, duke parashtruar se në dijeninë e tij, sipas kuadrit ligjor në fuqi, një mjet nuk mund të përdoret jashtë Republikës së Shqipërisë nëse përdoruesi nuk pajisej me policë sigurimi. Trupi gjykues çmon se policat e sigurimit të automjetit lidhen ekskluzivisht me të dhe nuk kanë të bëjnë me drejtuesin e tij. Këtu sjellim në vëmendje se në kohën që ky mjet figuronte në pronësi të shtetasit A.L , subjekti dispononte një prokurë të posaçme, në bazë të së cilës kishte tagra të plotë mbi këtë automjet e, për rrjedhojë, përdorimin e tij brenda dhe jashtë vendit. Ky fakt vlerësohet se është i mjaftueshëm për autoritetet në lejimin e përdorimit të këtij automjeti, qoftë edhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Gjithsesi, sjellim në vëmendje se policat e sigurimit është lëshuar përpara prokurës së posaçme të bërë nga shtetasi A.L . Nga ana tjetër, duket se subjekti ka kryer dalje me këtë automjet nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Kosovës, e cila nuk kërkon pajisjen me policë kufitare apo karton jeshil për sigurimin e tij jashtë territorit shqiptar. Thënë kjo rrethanë, Komisioni do ta gjente të pranueshëm shënimin e emrit të tij si “përdorues” në policat kufitare apo kartonë jeshilë, të cilët përgjithësisht kanë kohëzgjatje më të shkurtër kohore, në kushtet e përdorimit të këtij automjeti vetëm për dalje jashtë vendit.

78. Nga hetimi i kryer rezultoi e provuar se ky automjet është përdorur nga subjekti për udhëtime jashtë vendit në periudhën që figuronte në pronësi të shtetasit A.L , si dhe në periudhën që figuronte në pronësi të shtetasit B.D .

79. Këto rrethana, si dhe fakti se ky automjet nuk është përdorur kurrë për ndonjë udhëtim jashtë vendit nga pronarët e tij *de jure*, dëshmojnë përdorimin e tij ekskluzivisht nga subjekti i rivlerësimit.

80. Në këtë kontekst, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit e ka pasur në përdorim këtë automjet edhe në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

80.1 Por mosdeklarimi i kësaj pasurie në përdorim në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* do të vlerësohet si një nga elementet në arritjen e konkluzionit përfundimtar për pasuri të fshehur të subjektit, duke mos çmuar se në lidhje me këtë rrethanë subjekti ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë të pasurisë në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

81. Në vijim të arsyetimit, Komisioni vëren se vetë prokura e posaçme e lëshuar nga shtetasi A.L e vendos subjektin në kushtet e një pronari *de facto* të këtij automjeti, me të drejta të plota për shitblerjen e tij, qoftë edhe vetes, duke përcaktuar çmimin e shitjes edhe pa kundërshtim. Ky fakt, i vlerësuar në raport me rrethanën nga ku duket se nuk ka pasur një marrëdhënie të konsoliduar shoqërore mes subjektit dhe shtetasit A.L , të tillë që prej tij të lëshohej një prokurë me këtë përmbajtje në kushtet e një vetëbesimi të tepruar, tregon që kemi të bëjmë me një pasuri të porositur e të blerë nga subjekti, por të regjistruar në emër të këtij shtetasi. Në këtë këndvështrim, Komisioni vëren se edhe në vijim subjekti është sjellë si pronar i këtij automjeti, duke ia shitur djalit të tezes së tij, por gjithsesi duke vazhduar ta përdorë atë, në dukje veprim ky i kryer për të shkëputur lidhjen e kësaj pasurie me shtetasin A.L .

82. Lidhur me deklaratat noteriale të shtetasve A.L dhe B.D , të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar përdorimin e automjetit, sjellim në vëmendje qëndrimet që ka mbajtur Kolegji në jurisprudencën e tij në çështje të ngjashme, sipas të cilave deklarata noteriale, megjithëse nuk është e pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e saj provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështetet nga rrethanat apo provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

83. Ndërsa, sa i përket pretendimit të subjektit se shtetasit A.L dhe B.D , si dhe ai vetë kanë pasur burime financiare të ligjshme të cilat mundësonin plotësisht blerjen e kësaj pasurie, duke hedhur poshtë dyshimet e ngritura mbi pasuri të fshehur, Komisioni argumenton se verifikimi i ligjshmërisë së burimeve financiare të subjektit dhe/apo personave të tjerë të lidhur për blerjen e një pasurie të dyshuar si të fshehur vlerësohet si një nga elementet, e cila analizuar në harmoni me të gjitha të dhënat/rrethanat/faktet dhe provat e tjera mund të çojë në konstatimin për pasuri të fshehur. Pra, verifikimi i ligjshmërisë së burimeve financiare nuk mund të qëndrojë në asnjë rast si rrethanë e vetme e konstatuar, e cila mund të çojë në konkluzionin për pasuri të fshehur. Por, në çdo rast do të vlerësohet dhe analizohet në tërësi me rrethanat e tjera të evidentuara në raport me dyshimet e ngritura për pasuri të fshehur të subjektit.

84. Si konkluzion, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, si dhe provat shpresore të administruara në dosje, Komisioni arrin në përfundimin se kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

85. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se në këtë rast subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për shkarkimin e tij, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji.

Analiza financiare për vitet 2000 – 2003 dhe 2004 – 2016³⁰

86. Bazuar në: (i) dokumentacionin e administruar në dosje; (ii) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI; (iii) shpjegimet e dhëna gjatë procesit të hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit – Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për vitet 2000 – 2003 dhe 2004 – 2016, nga ku duket se vitet 2010, 2011 dhe 2013 paraqiten me balancë negative të fondeve në fund të çdo viti, konkretisht: (a) për vitin 2010 – balanca negative e fondeve -171,247 lekë; (b) për vitin 2011 – balanca negative e fondeve -1,674,537 lekë; (c) për vitin 2013 – balanca negative e fondeve -74,058 lekë.

87. Si konkluzion, referuar kësaj analize rezulton një balancë negative fondesh, në total në vlerën prej rreth 1.9 milionë lekësh, nga ku Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen/mbulimin e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitet 2010, 2011 dhe 2013, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të pasurisë

88. Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit, si dhe provat shkresore të administruara në dosje lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) ka kryer fshehje të pasurisë, duke u vendosur në kushtet e parashikuara sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për shkarkimin e tij nga detyra në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

89. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur/ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

90. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin³¹ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Milan Laskaj, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) për

³⁰ Referojuni tabelës së analizës përmbledhëse të treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, Aneks nr. 1 – pjesë e këtij vendimi.

³¹ Raporti i AKSIK-së nr. *** prot., datë 2.11.2017.

subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

91. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Milan Laskaj.

92. Komisioni ka kërkuar nga AKSIK-ja përditësimin e raportit mbi kontrollin e figurës me informacione të reja të mundshme, të përcjella rishtazi nga organet e verifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Milan Laskaj³². AKSIK-ja ka dërguar në Komision shkresat e administruara nga institucionet e verifikimit, pas përpilimit të raportit mbi kontrollin e figurës për këtë subjekt. Nga verifikimi i tyre nuk rezulton të jenë përcjellë informacione apo sinjalizime mbi kontakte të papërshtatshme dhe/apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit, z. Milan Laskaj, në veprimtari të kundërligjshme.

93. Në këtë kontekst, AKSIK-ja nuk ka përpiluar një raport të ri për subjektin e rivlerësimit, z. Milan Laskaj, porse me vendimin nr. *** prot., datë 4.7.2023, të KDZH-së, ka deklasifikuar plotësisht raportin mbi kontrollin e figurës të dërguar më parë në Komision, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës³³.

94. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës

95. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Milan Laskaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti i Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale³⁴

96. Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale pranë KLP-së, si organi ndihmës i vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, me short; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore – ka përpiluar një raport me qëllim analizimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, z. Milan Laskaj.

³² Shkresë e Komisionit nr. *** prot., datë 10.2.2023.

³³ Dërguar raporti i kontrollit të figurës, i deklasifikuar plotësisht, me shkresën e AKSIK-së nr. *** prot., datë 6.7.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2023.

³⁴ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 23.5.2023.

96.1 Referuar këtij raporti, rezulton se subjekti i rivlerësimit përpiqet të tregojë korrektësi në zbatimin e ligjit, si dhe shfaq aftësi në arsyetimin ligjor. Gjithashtu konstatohet se ai ka respektuar të drejtat e palëve në proces, si dhe është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Si konkluzion, nuk konstatohen *indicie* apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

97. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, nga ku pas shqyrtimit të tyre nuk u konstatuan problematika lidhur me vlerësimin profesional.

98. Në vlerësimin e prokurorit Milan Laskaj u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe rreth 40 denoncime të depozituara nga publiku, nga verifikimi i të cilave rezulton se disa janë të përsëritura dhe pjesa e më e madhe e tyre janë anonime dhe për çështje të njëjta dhe/apo të ngjashme.

99. Pas shqyrtimit dhe analizimit të tyre, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, me dërgimin e rezultateve të hetimit – Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe/apo të provojë me dokumentacion justifikues ligjor mbi veprimet e kryera prej tij në hetimin dhe shqyrtimin e disa çështjeve penale, që lidhen me denoncimet depozituara nga publiku, si dhe për rrethana të karakterit administrativ, që lidhen me funksionin e tij si ish-drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Më konkretisht, Komisioni konstatoi se ngrihen pretendime, hidhen dyshime dhe/apo duket se evidentohen gjetje, të pasqyruara në mënyrë të përmbledhur si vijon:

Të lidhura me funksionin e prokurorit

99.1 Evidentohet mungesa e kryerjes së veprimeve hetimore apo moskryerja e veprimeve të duhura hetimore për dy çështje penale, që lidhen me dy raste të denoncuar nga publiku, përkatësisht denoncimet e shtetasve I.M³⁵ dhe Gj.Gj³⁶.

99.2 Duket se subjekti ka pyetur një shtetas si person që ka dijeni në lidhje me rrethanat e një kallëzimi penal, për të cilin më parë kishte vendosur mosfillimin, konkretisht për çështjen penale që lidhet me denoncimet e bëra nga shtetasi I.M³⁷.

99.3 Për një rast të denoncuar nga publiku (ankesa e shtetasit A.K)³⁸, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të referojë provat e administruara gjatë hetimit paraprak dhe shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale, të cilat bazuar në nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale janë çmuar prej tij si të tilla, të cilat kanë bërë që fillimisht të regjistrojë procedimin penal për veprën penale “Plagosja e rëndë me dashje” e në vijim “Plagosja e lehtë me dashje”, me të cilën përfundimisht janë akuzuar dy të pandehurit e kësaj çështjeje penale, në dukje ndryshe nga sa pretendon denoncuesi (viktima e veprës penale), sipas të cilit duhej të ngrihej akuza “Vrasja me paramendim”, e mbetur në tentativë. Gjithashtu, në lidhje me këtë rast, subjektit iu kërkua të japë shpjegimet/argumentet e tij për faktin e konstatuar mbi mosankimin e vendimit penal të

³⁵ Ankesat nr. *** prot., datë 28.9.2018 dhe nr. *** prot., datë 9.7.2019.

³⁶ Ankesë nr. *** prot., datë 6.2.2019.

³⁷ Ankesat nr. *** prot., datë 28.9.2018 dhe nr. *** prot., datë 9.7.2019.

³⁸ Ankesë nr. *** prot., datë 12.3.2021.

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për ndryshimin e masës së sigurimit personal për të pandehurin S.D.

Të lidhura me funksionin e drejtuesit të Prokurorisë

99.4 Nga verifikimi i denoncimeve të shumta në lidhje me të njëjtën tematikë dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, konstatohen problematika në lidhje me krijimin e seksioneve të reja, si dhe procedurën e ndjekur për shortimin dhe ndarjen e çështjeve për periudhën që subjekti ka qenë drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

99.5 Në një rast tjetër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka përpiluar dy urdhra për kthim të sendeve të sekuestruara në cilësinë e provës materiale në kuadër të një procedimi penal të regjistruar për një çështje e cila nuk po hetohej/ndiqej nga ana e tij.

99.6 Në lidhje me një çështje tjetër, evidentohet aplikim i gabuar i nenit 78 të Kodit të Procedurës Penale, duke shpallur moskompetencën për ndjekjen e një procedimi penal.

99.7 Gjithashtu, duket se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Lezhë nuk ka ndjekur procedurat e rregullta ligjore për rekrutimin e një punonjësi në këtë Prokurori.

100. Me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet/argumentet e tij, si dhe ka depozituar dokumentacion provues në mbështetje të tyre për kërkesat e bëra dhe problematikat e ngritura nga Komisioni në trajtimin e denoncimeve të depozituara nga publiku dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër.

101. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet, çmon se përgjithësisht subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse dhe në nivel ligjor mbi kërkesat dhe/apo gjetjet e evidentuara në trajtimin e denoncimeve të depozituara nga publiku, që lidhen me dosjet penale të shqyrtuara prej tij, në cilësinë e prokurorit të çështjes. Kështu, nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje procedurale, të tilla që mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit profesional

102. Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku, dosjeve penale të administruara në këtë kuadër, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

103. Për kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues, në bazë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, konkluzionet lidhur me çështjet dhe denoncimet e shqyrtuara në kuadër të këtij gjykimi nuk i konsideroi të mjaftueshme për të konkluduar në bazë të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

104. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

Mbi gjetjet e evidentuara në lidhje me funksionin si drejtues Prokurorie

105. Pasi Komisioni vlerësoi me objektivitet parashtrimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore në lidhje me gjetjet e evidentuara sa i përket kryerjes së funksionit të tij si drejtues Prokurorie, konkludon se:

105.1 Ka rezultuar se prej subjektit të rivlerësimit është bërë ndarja e çështjeve penale pa iu nënshtruar procedurave të shortit manual dhe/apo elektronik, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 53 të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimin nr. 3, datë 29.12.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”³⁹. Gjithashtu evidentohet mosshpërndarja te prokurori i gatshëm të një çështjeje penale që ka nevojën për kryerjen e veprimeve të menjëhershme hetimore, sipas grafikut të miratuar prej tij, në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 29.12.2016, “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” dhe praktikën e ndjekur në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm⁴⁰.

105.2 Kështu, referuar rasteve të evidentuara më sipër, si dhe denoncimeve të shumta anonime të ardhura me këtë tematikë, në kuadër të verifikimeve të kryera lidhur me organizimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe procedurën e ndjekur për shortimin dhe ndarjen e çështjeve për periudhën që subjekti ka qenë drejtues i kësaj Prokurorie, Komisioni konstaton se: (i) ndryshimi i strukturës së Prokurorisë së Rrethit Lezhë (krijimi i një sektori/seksioni të ri) nga subjekti i rivlerësimit ka shkaktuar pamundësinë e funksionimit të sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve; (ii) subjekti nuk ka respektuar kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, për krijimin e seksionit të ri; (iii) nuk evidentohet asnjë gjurmë e urdhrat që pretendohet se është lëshuar nga subjekti i rivlerësimit për ndryshimin e strukturës së Prokurorisë; (iv) është e paqartë se kur është rikuperuar sistemi elektronik dhe nëse subjekti i vlerësimit, në zbatim të detyrave të tij funksionale dhe kompetencave si drejtues i Prokurorisë, ka bërë përpjekje për sigurimin e funksionimit të sistemit⁴¹.

105.3 Gjithashtu, sikurse u evidentua edhe më sipër, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka përpiluar dy urdhra për kthim të sendeve të sekuestruara në cilësinë e provës materiale në kuadër të një procedimi penal të regjistruar dhe në hetim e sipër në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për një çështje e cila nuk po hetohej/ndiqej nga ana e tij. Në lidhje me këtë rast, trupi gjykues përfundimisht vlerëson se ai ka cenuar pavarësinë e prokurorit të çështjes, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 6 të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e

³⁹ Shihni denoncimin anonim nr. *** prot., datë 31.3.2022, si dhe informacionin dhe dokumentacionin e dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë në lidhje me problematikën e ngritur në këtë ankesë, me shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 29.2.2024).

⁴⁰ Referojuni dy ankesave me nr. *** prot., datë 31.3.2022 dhe nr. *** prot., datë 31.3.2022, të shqyrtuara në raport me informacionin dhe dokumentacionin e dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë me shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 29.2.2024), në lidhje me dosjen e procedimit penal nr. ***/***, për veprat penale “Shkatërrimi i pronës me zjarr” dhe “Vjedhja me dhunë”, në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 151/2 dhe 139-25 të Kodit Penal.

⁴¹ Referojuni informacionit dhe dokumentacionit të administruar nga ONM-ja, dërguar me shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë nr. *** prot., datë 28.2.2024 (protokolluar në ONM me nr. *** prot., datë 5.3.2024).

Shqipërisë”. Gjithashtu, duket se ai ka shfrytëzuar cilësinë e tij si drejtues i kësaj Prokurorie, duke i përcjellë këto urdhra në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë⁴².

105.4 Sa i përket gjetjeve të tjera të lidhura me pozicionin e subjektit të rivlerësimit si drejtues i Prokurorisë së Rrethit Lezhë, Komisioni vlerëson se subjekti ka argumentuar në mënyrë bindëse në lidhje me to dhe se gjithsesi ato janë të tilla, të cilat nuk mund të ndikojnë në vlerësimin përfundimtar të subjektit për efekt të këtij procesi.

Vlerësimi tërësor i çështjes

106. Në vlerësimin tërësor të çështjes, bazuar në nenin 4, pika 2 dhe nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, pasi: (i) u konkludua se ai ka pasur pasuri të fshehur, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016; (ii) në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka dështuar të krijojë seksionet, të organizojë dhe dokumentojë shpërndarjen e çështjeve të regjistruara në këtë prokurori, bazuar në kritere objektive dhe transparente, si dhe të sigurojë përdorimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve, në përputhje me parashikimet e neneve 21 dhe 42, shkronjat “c” dhe “h” të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe pikës 2, kreu II i udhëzimit nr. 3, datë 29.12.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”; (iii) ka cenuar pavarësinë e prokurorit të çështjes, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 6 të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi rezulton se: (i) ka kryer fshehje të pasurisë; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të saj. Gjithashtu, në vlerësimin tërësor të çështjes, në kushtet kur ka rezultuar me pasuri të fshehur, si dhe pas verifikimit dhe analizimit të veprimtarisë së subjektit të rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Lezhë, trupi gjykues arriti në përfundimin se ai ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë

⁴² Referojuni ankesës nr. *** prot., datë 25.11.2021, të shqyrtuar në raport me informacionin dhe dokumentacionin e dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë me shkresën nr. *** prot., datë 4.12.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.12.2023), në lidhje me dosjen e procedimit penal nr. *** të vitit 2020, për veprën penale “Drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt” (pa leje drejtimi), parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si dhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Milan Laskaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 27.3.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Alma FASKAJ
Kryesuese

Pamela QIRKO
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

ANEKSI NR. 1 – TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE

	2000-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) PASURI	0	0	35,329	74,867	337,131	-292,697	38,180	1,246,455	5,049,695	171,813	154,097	-174,780	306,377	511,256
Apartament banimi me sip.78.9 m2 ndodhur në Lagjen Q Njësia Administrative D								1,388,100						
Apartament banimi me sip.91.4 m2 ndodhur në rr. "****", Lagja Q Njësia Administrative D.									5,255,400					811,620
Ndryshim likuiditeti	0	0	35,329	74,867	337,131	-292,697	38,180	-141,645	-205,705	171,813	154,097	-174,780	306,377	-300,364
B) DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	2,597,900	0	0	0	0	0
Detyrim I mbetur ndaj shoqërisë "****" Shpk									1,106,400					
Hua e marë nga shtetasi P.H								-						
Hua e marë nga shtetasi I.M									-					
Hua e marë nga shtetasi N.L									691,500					
Hua e marë nga shtetasja Z.B									-					
Kredi pranë Credins Bank									800,000					
C) PASURI NETO (A-B)	0	0	35,329	74,867	337,131	-292,697	38,180	1,246,455	2,451,795	171,813	154,097	-174,780	306,377	511,256
D) TË ARDHURA	2,339,663	977,262	997,752	988,975	1,137,113	1,178,511	1,401,050	1,211,828	1,027,034	1,060,531	1,031,310	1,610,340	1,755,279	2,641,310
Të ardhura nga paga e subjektit	2,339,663	977,262	997,752	988,975	1,132,009	1,178,511	1,401,050	1,211,828	1,027,034	1,060,531	1,031,310	1,212,606	1,259,325	1,264,015
Të ardhura nga paga dhe raportet e barrëlindjes B.SH												208,980	230,076	556,620
Të ardhura nga fitimi I ushtrimit të aktivitetit S.L PF												188,754	265,878	820,675
Të ardhura nga revokimi I kontratës së kaparit me shoqërinë "****" shpk														
Të ardhura nga interesat e depozitës bankare					5,104									
E) SHPENZIME	331,728	93,864	109,557	109,557	142,666	136,620	150,337	136,620	249,776	874,039	951,271	1,329,216	1,141,445	805,276
Shpenzime jetike	331,728	93,864	109,557	109,557	136,620	136,620	136,620	136,620	136,620	141,024	141,024	475,196	672,828	705,276
Shpenzime mobilimi apartamenti në Q Tiranë										182,000	90,000	15,000		100,000
Shpenzime për kthim huaje ndaj shtetasit P.H														
Shpenzime për kthim huaje ndaj shtetasit I.M										279,440	280,420	140,110		
Shpenzime për kthim huaje ndaj shtetasit N.L												420,330	275,300	
Shpenzime për kthim huaje ndaj shtetasës Z.B														
Shpenzime për kredinë pranë Credins Bank									113,156	271,575	271,575	271,575	158,904	
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit		0	0	0	6,046	0	13,717	0	0	0	168,252	7,006	34,413	0
Balanca e fondeve (D-C-E)	2,007,935	883,398	852,866	804,551	657,317	1,334,588	1,212,533	-171,247	-1,674,537	14,679	-74,058	455,904	307,458	1,324,778